



SINJALIZUESI

Mbrojtja e Sinjalizuesve në Kosovë

ANALIZE

IDT | Sinjalizuesi | 05.02.2024

Përmbajtja:

1. HYRJE	3
2. SITUATA AKTUALE PËR MBROJTJE TË SINJALIZUESVE	6
3. ÇKA ËSHTË SINJALIZIMI.....	8
4. SINJALIZIMI DHE INTERESI PUBLIK.....	9
5. SINJALIZUESIT JO VETËM SI PUNËTORË.....	11
6. CILAT INSTITUCIONE OBLIGOHEN TË KENË MEKANIZMA RAPORTUESE	12
7. SINJALIZIMI I JASHTËM	14
8. SI MUND TË SINJALIZOHET	15
9. ÇFARË MBROJTJE OFROHET PËR SINJALIZUESIT?	16
10. BARRA E PROVËS	18
11. ANONIMITETI DHE KONFIDENCIALITETI	19
12. DISPOZITAT KUNDËRVAJTËSE PËR MOSZBATIM TË LIGJIT	21
13. NXITJA E KULTURËS SË SINJALIZIMIT	22
14. KAPACITETEVE NJERËZORE PËR PRANIM DHE TRAJTIM TË SINJALIZIMEVE	24
15. PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË NË TRAJTIMIN E SINJALIZIMEVE	26
16. REKOMANDIMET	27

1. HYRJE

Mbrojtja e sinjalizuesve është një aspekt i rëndësishëm i sundimit të ligjit, drejtësisë dhe integritetit, veçanërisht në kohën e zhvillimeve teknologjike dhe shoqërore. Rishikimi i kornizës ligjore për mbrojtjen e sinjalizuesve paraqet një sfidë thelbësore për sistemin juridik të Kosovës. Në këtë kontekst, është e nevojshme të shqyrtohet dhe përditësohet korniza ligjore, në mënyrë që të përmbush nevojat aktuale dhe të mbrojë efekti visht ata që denoncojnë shkeljet e ligjit.

Ky raport si rishikimi i kornizës ligjore për mbrojtjen e sinjalizuesve synon të adresojë disa sfida dhe të përmirësojë efektivitetin e procesit të sinjalizimit. Kjo analizë është bërë me qëllim të rritjes së sigurisë dhe mbrojtjes së interesave të sinjalizuesve, duke stimuluar kështu raportimin dhe ndërgjegjësimin publik në lidhje me sinjalizimin. Po ashtu, ky raport synon të analizojë efikasitetin e mekanizmave të sinjalizimit, duke pasqyruar zbatimin e ligjit për mbrojtje të sinjalizuesve në praktikë. Përdorimi i teknologjisë dhe inovacionit po ashtu krijon një fushë për përmirësime dhe përshtatje të kornizës ligjore me zhvillimet aktuale. Këto pika të përqendruara synojnë të krijojnë një mjedis ligjor të fortë dhe modern për sinjalizuesit, duke theksuar rëndësinë e kontributit të tyre në sundimin e ligjit dhe drejtësinë.

Nisur nga përvojat e sinjalizuesve, ky raport synon të ofrojë rekomandime konkrete për përmirësimet e nevojshme në bazën ligjore. Këto rekomandime do të adresojnë sfidat dhe nevojat e identifikuar gjatë procesit të sinjalizimit dhe do të përqendrohen në forcimin e mbrojtjes së identitetit të sinjalizuesit, nxitjen e sinjalizimit dhe përmirësimin e efikasitetit të mekanizmave të sinjalizimit.

Këto rekomandime synojnë të ndihmojnë në hartimin e një kornize ligjore që reflekton realitetin aktual dhe adreson nevojat e sinjalizuesve në mënyrë efektive.

Kosova ka punuar aktivisht në drejtim të harmonizimit të kornizës së saj ligjore me legjislacionin e Bashkimit Europian (BE) në shumë fusha, përfshirë mbrojtjen e sinjalizuesit. Transpozimi i Rregullores së BE për Mbrojtjen e Sinjalizuesit në sistemin juridik të Kosovës është një hap i rëndësishëm drejt përmbushjes së standardeve ndërkombëtare. Megjithatë, efikasiteti i këtyre përpjekjeve vjen në pyetje kur merren në konsideratë sfidat që përballen në zbatimin dhe adaptimin e një legjislacioni të tillë në kontekstin unik të mjedisit juridik të Kosovës.

Ndërsa Kosova mund të krenohet me suksesin e transpozimit të legjislacionit të BE në lidhje me mbrojtjen e sinjalizuesit në kornizën ligjore të saj, aspekti kyç i zbatimit mbetet një sfidë e madhe. Veprimi i transpozimit përfshin adaptimin e tekstit ligjor, por ndikimi real në terren varet nga se sa mirë këto ligje janë zbatuar dhe integruar në kontekstin ekzistues ligjor dhe shoqëror.

Për fat të keq, edhe pse janë plotësuar kërkesat formale të transpozimit, korniza ligjore e Kosovës në lidhje me mbrojtjen e sinjalizuesit ka treguar një mungesë në adaptimin efektiv në rrethanat specifike të vendit. Për shembull, dispozitat ligjore mund të mos adresojnë efektivisht sfidat që hasin sinjalizuesit në Kosovë, duke krijuar një hendek midis mbrojtjes teorike të ofruar nga ligji dhe mbrojtjes praktike të nevojshme në kontekstin lokal.

Një shembull ilustrues i këtij hendeku është mbështetja në sistemin e gjyqësor për mbrojtjen e Sinjalizueseve. Ligji ofron sinjalizueseve mundësinë për të kërkuar mbrojtje nëpërmjet gjykatave kundër masave hakmarrëse. Por megjithatë, ritmi i ngadalshëm i procedurave gjyqësore në Kosovë, ku çështjet mund të zgjasin deri në pesë vjet për një vendim përfundimtar, ul efektivitetin e këtij mekanizmi. Sinjalizuesit kanë nevojë për mbrojtje të menjëhershme për të parandaluar ndëshkimet, duke bërë sistemin gjyqësor një zgjidhje të pamundur në këtë gjendje aktuale.

Ndërsa transpozimi i legjislacionit të BE është një hap në drejtim të duhur, Kosova duhet të tejkalohet nga përshtatja minimale dhe të përqendrohet në krijimin e një kornize ligjore që ofron mbrojtje të fuqishme dhe të menjëhershme për sinjalizuesit. Një vlerësim i detajuar i mjedisit ligjor vendas, nuancave kulturore dhe sfidave specifike të sinjalizuesve në Kosovë është i nevojshëm për të mbushur hendekun ekzistues.

Kosova duhet të shpejtojë proceset gjyqësore në lidhje me mbrojtjen e sinjalizuesve për të siguruar zgjidhje të shpejta, duke parandaluar masat hakmarrëse të mundshme kundër tyre.

Rritja e ndërgjegjësimit rreth rëndësisë së raportimit dhe mbështetja publike për sinjalizuesit mund të krijojë një mjedis më mbështetës, duke nxitur një kulturë ku individët ndihen të fuqizuar për të denoncuar padrejtësitë.

Përfshirja e organizatave jo qeveritare mund të përmirësojë zbatimin e ligjeve për mbrojtjen e sinjalizuesve duke përdorur ekspertizën dhe rrjetet e tyre për të monitoruar dhe avokuar për mekanizma efikase të mbrojtjes.

Vlerësimet e rregullta të legjislacionit për mbrojtjen e sinjalizuesve duhet të kryhen për të identifikuar mangësitë dhe përshtatur kornizën ligjore me kushtet e ndryshme, duke siguruar që ajo të mbetet efektive dhe relevante.

2. SITUATA AKTUALE PËR MBROJTJE TË SINJALIZUESVE

Kosova ka zhvilluar kornizën ligjore për mbrojtjen e sinjalizuesve, duke u bazuar në Direktivën e miratuar nga Bashkimi Europian më 7 tetor 2019 (tutje, Direktiva). Kjo direktivë ka për qëllim të sigurojë një nivel të lartë mbrojtjeje për personat që sinjalizojnë keqpërdorime. Disa aspekte pozitive të kësaj direktive janë:

Mbrojtja e sinjalizuesve në sektorin publik dhe privat: Direktiva mbulon të dy sektorët, duke shtuar një shtrirje të gjerë në subjektet që ajo mbron. Kjo shtrirje mundëson përfshirjen jo vetëm të sinjalizuesve potencialë brenda kornizës tradicionale, por edhe personat në çfarëdo marrëdhënie pune, konsulentët, kontraktorët, vullnetarët dhe aplikuesit për punë ashtu siç edhe parashihet në direktivën e BE-së.

Mbrojtja e të dhënave dhe identitetit: Direktiva siguron mbrojtjen e identitetit të sinjalizuesve pa marrë parasysh motivin që i shtyn ata në raportim apo publikim të sinjalizimit. Identiteti mbahet konfidencial, duke përfshirë rastet e raportimeve anonime, dhe çka është më e rëndësishme ndalohet hakmarrja ndaj sinjalizuesve.

Lehtësime dhe mbrojtje ekonomike: Direktiva parashikon lehtësime për sinjalizuesit për të mbajtur statusin e tyre profesional dhe financiar, duke u ofruar asistencë ekonomike dhe ligjore sipas nevojës. Kjo është e rëndësishme për garantimin e mbrojtjes efektive të tyre.

Këshillim dhe informim: Sipas direktivës shtetet anëtare duhet të sigurojnë këshillim të kuptueshëm dhe falas për të gjithë personat që duan të bëjnë një raportim, duke ndihmuar në ndërgjegjësimin dhe lehtësimin e procedurave të aplikimit.

Detyrime ligjore për institucionet: Direktiva vendos detyrim ligjor për krijimin e mekanizmave të brendshëm në sektorin publik dhe privat për të mbështetur sinjalizuesit. Po ashtu, detyron institucionet përgjegjëse të informojnë sinjalizuesin mbi rezultatet e kallëzimit të tij në një afat të arsyeshëm.

Ligji aktual i Kosovës për mbrojtjen e Sinjalizuesve është draftuar si transpozim i kësaj direktive, duke përfshirë elementët bazë por duke mos bërë sa duhet në përpjekje që të përshtatet me sistemin juridik dhe rrethanat lokale. Kjo përfshirje e rrethanave

lokale do të sigurojë që ligji të jetë efektiv në praktikë dhe të mbrojë sinjalizuesit në mënyrë të përshtatshme në kontekstin e Kosovës.

Më 24 shtator 2011, u miratua Ligji për Mbrojtjen e Informatorëve, një hap drejt ndërtimit të një mekanizmi ligjor për ata që vendosën të ndajnë informacione mbi sjellje të dyshimta brenda institucioneve publike.

Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve 2019, i cili zëvendësoi Ligjin për Mbrojtjen e Informatorëve, shërben si një përmirësim i nevojshëm. Ky ligj ka për qëllim të krijojë një sistem më të gjerë dhe të efektshëm për raportimin e shkeljeve në sektorin publik dhe privat, duke siguruar një mbrojtje më të përmbushur dhe mekanizma më të fuqishme ligjore për sinjalizuesit.

Me këtë ligj një hap i rëndësishëm është bërë në drejtëm të sigurimit të një kornize ligjore më të përshtatshme dhe më të sinkronizuar me kërkesat e Direktivës. Përmes këtij ligji, institucionet publike dhe subjektet private detyrohen të krijojnë mjedise të sigurta dhe procedura të qarta për raportimin e shkeljeve. Kjo përfshin edhe përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të sinjalizuesve, duke mbrojtur integritetin e tyre nëpërmjet mbrojtjes gjyqësore.

Gjithsesi, ndryshimet ligjore duhet shoqëruar me një ndërgjegjësim të thellë në shoqëri për rëndësinë e sinjalizimit dhe respektin për integritetin e atyre që vendosin të raportojnë kundër shkeljeve. Nëse ky ndërgjegjësim nuk përcillet në praktikë dhe në kulturën organizative të një institucioni publik apo privat, përfitimet e plotësimit ligjor mund të jenë të kufizuara. Kjo sfidë bëhet akoma më e ndjeshme në sektorin privat, ku burimet janë më të limituara dhe rezistenca ndaj ndryshimeve të reja mund të jetë më e lartë.

Me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Kosova mund të ndërtojë një mjedis ku raportimi i shkeljeve është i favorshëm dhe ku individët ndihen të mbrojtur dhe të inkurajohen për të sjellë në vëmendje sjellje të dyshimta, pavarësisht sektorit ku ata punojnë.

Plotësimi i ligjit me akte nënligjore

Nga këndvështrimi kohor i miratimit të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në Kosovë më datë 18 dhjetor 2018, vërehet se ka pasuar një vonesë të konsiderueshme në implementimin e tij sa i përket plotësimit me akte nënligjore. Për shembull, Rregullorja (QRK) Nr. 03/2021, e cila ka për qëllim përcaktimin e procedurës për

pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit, është publikuar më datën 7 maj 2021. Kjo vonesë në hartimin e rregullores për implementimin e ligjit tregon për një shpërfillje ose mungesë të proaktivitetit në zbatimin efektiv të këtij ligji nga institucionet përgjegjëse.

Po ashtu, vendimi nga Qeveria e Republikës së Kosovës për publikimin e udhëzuesit për mbrojtjen e personave që raportojnë në interes publik dhe detyrimet e punëdhënësve për mbrojtjen e sinjalizuesve është bërë më datë 19 shtator 2023. Kjo tregon se ka pasur një vonesë të shtuar dhe ngadalësim në zbatimin e masave konkrete dhe të nevojshme për të siguruar mbrojtjen dhe integritetin e sinjalizuesve, duke qenë se vendimet e qeverisë japin masa apo hapa konkret për zbatimin e një akti ligjor.

Kjo vonesë në implementim mund të sjellë sfida administrative si mungesa e burimeve të nevojshme të dedikuara për zbatim ose mungesa e vetëdijes për rëndësinë e krijimit të një mjedisi mbrojtës për sinjalizuesit. Është thelbësore që institucionet përgjegjëse të angazhohen me shpejtësi për të zbatuar masat e nevojshme dhe të përmirësojnë transparencën dhe llogaridhënien në trajtimin e rasteve të sinjalizimeve. Ky proces duhet të përmbushet në përputhje me synimet dhe standardet e ligjit për të garantuar një mbrojtje efektive dhe plotësuese për ata që zgjedhin të denoncojnë shkeljet e korrupsionit dhe sjelljet jo etike.

Për të garantuar zbatimin e këtyre akteve nënligjore, është e nevojshme që institucionet përgjegjëse të zhvillojnë një sistem të strukturuar të monitorimit dhe vlerësimit, duke përfshirë edhe raportime periodike mbi rezultatet dhe ndikimin e tyre në kulturën e sinjalizimit dhe luftën kundër korrupsionit. Ky mekanizëm i matjes së efikasitetit do të siguronte përgjegjshmëri dhe transparencë në zbatimin e ligjit dhe do të kishte një ndikim pozitiv në forcimin e integritetit institucional.

3. ÇKA ËSHTË SINJALIZIMI

Sinjalizuesi është një person, pavarësisht nga pozita e saj/tij në punë, në një kompani private apo institucion publik, që publikon apo raporton informacione lidhur me një veprim të paligjshëm ose jo etik. Këto veprime të paligjshme përfshijnë format e mashtrimit, korrupsionit, apo aktivitete tjera të paligjshme. Roli i sinjalizuesit është

esencial në luftën kundër korrupsionit. Sinjalizuesit janë një mbrojtës etik që ekspozojnë veprimet me ndikim negativ në mirëqenien e publikut.

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në Kosovë, Sinjalizuesit raportojnë dëmet të interesit publik, në kontekstin e marrëdhënieve të tyre të punës, në sektorin publik ose privat. Ligji përdor termin "Sinjalizues," duke e definuar atë si çdo person që raporton apo shpall informacione lidhur me një kërcënim ose dëm të interesit publik në lidhje me punën e tyre në sektorin publik ose privat.

4. SINJALIZIMI DHE INTERESI PUBLIK

Për të përmbushur kërkesën e interesit publik, shqetësimet e sinjalizuesit duhet të kenë një ndikim më të gjerë sesa vetëm mbi institucionin ku punon. Për shembuj, shqetësime rreth shkeljeve të buxhetit qeveritar ose abuzimeve me një skeme sociale janë raste që mund të përmbushin kriterin e interesit publik. Në rastet kur shqetësimet kanë ndikim vetëm mbi trajtimin personal të sinjalizuesit në vend të interesit publik, atëherë nuk plotësohet kushti për mbrojtje sipas ligjit për mbrojtjen e Sinjalizueseve.

Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në Kosovë, në Nenin 5, përcakton rastet kur një raportim konsiderohet si shkelje e interesit publik. Sipas ligjit, sinjalizimi dhe shpalosja e informacionit në interes publik përfshinë situatat kur një shkelje ligjore po ndodh, është duke ndodhur ose mund të ndodh në të ardhmen dhe kjo shkelje rrezikon shëndetin, sigurinë, apo mjedisin. Po ashtu, shkelja është kryer me veprim dhe mosveprim duke keqpërdorur detyrën zyrtare, apo duke kryer veprime diskriminuese në institucionet publike. Ligji po ashtu thekson se raportimi do të supozohet si në interes publik, në përputhje me një kriter të përgjithshëm, përveç nëse provohet e kundërta.

Në disa raste, raportimi i një shkeljeje nuk klasifikohet automatikisht si një sinjalizim sipas ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve. Për shembull, nëse një i punësuar supozon se punëdhënësi ka shkelur kontratën e punës, por kjo shkelje nuk ka efekt cenimin e interesit publik.

Në rastin e shkeljes së kontratës së punës, kur një i punësuar ndjehet se është i dëmtuar nga një mosrespektim i detyrimeve kontraktuale, ky shqetësim mund të klasifikohet si një çështje e interesit privat dhe jo të interesit publik. Në këto raste,

sinjalizuesi duhet të përdorë procedurat dhe mekanizmat e tjera që janë në dispozicion për të mbrojtur të drejtat e tyre individuale në zbatim të ligjit të punës, përfshirë ankesat dhe procedurat e ankimit.

Sinjalizimi sipas ligjit ka për qëllim të mbrojë sinjalizuesin në raste kur ai ose ajo del përpara dhe shpall informacione lidhur me shkelje të rëndë të interesit publik, duke përfshirë veprime të paligjshme, mashtrime, korrupsion, keqmenaxhim, apo shkelje të tjera që kanë një ndikim mbi publikun apo shoqërinë në përgjithësi.

Për tu klasifikuar si sinjalizim është e rëndësishme që raportimi të përfshijë veprime apo situata që kanë një ndikim të gjerë në interesin publik duke lënë anash shqetësimet e interesit individual.

Analiza e Nenit 5 të Ligjit të Kosovës për mbrojtjen e sinjalizuesve, është e rëndësishme për të kuptuar se si është përcaktuar interesi publik në këtë kontekst. Ky nen përcakton situatat kur raportimi dhe shpallja është e mbrojtur në interes publik. Por, definimi i interesit publik është i përgjithshëm dhe nuk specifikon fusha të veçanta. Kjo mund të shkaktojë konfuzion dhe të zvogëlojë vullnetin e sinjalizuesit për të raportuar. Do ishte e preferueshme të përcaktoheshin fushat specifike të interesit publik, duke përfshirë Prokurimin publik, Invasioni fiskal, Sigurinë në rrugë, Sigurinë në shëndet, për të lehtësuar identifikimin e çështjeve që trajtohen si interes publik, pra të plotësohet me disa fusha që mungojnë, psh përmendet dëmtimi i ambientit por mungojnë fusha specifike tjera sikur mbrojtja e konsumatorit, mbrojtja e kafshëve, mbrojtja e të dhënave personale, siguria në rrugë etj.

Kriteret e përcaktuara (shembuj si shkelja e ligjit, dështimi për të përmbushur detyrimet ligjore, keqadministrimi i drejtësisë, rrezikimi i shëndetit apo sigurisë) janë të përgjithshme dhe mund të interpretohen ndryshe nga secili individ. Specifikimet shtesë ose shembuj konkret mund të shtohen për të përcaktuar më qartë këto kritere dhe për të lehtësuar vlerësimin e situatave specifike.

Është e rëndësishme të sigurohet se kjo dispozitë nuk pengon mbrojtjen e të drejtave të sinjalizuesit duke mos identifikuar qartë interesin publik. Ligji nuk parasheh definim të interesit publik edhe pse e parasheh si bazë të rëndësishme për kualifikim të një raportimi si sinjalizim.

Shtetet rajonale dhe Europiane kanë përdorur praktikën e përcaktimit të sektorëve dhe situatave specifike kur raportimi paraqet interes publik. Kjo ka për qëllim të bëjë

të qartë për qytetarët dhe sinjalizuesit se cilat raste janë të rëndësishme dhe të mbrojtura për publikun. Këto përcaktime të detajuara ndihmojnë në lehtësimin e identifikimit të çështjeve dhe situatave që mund të raportohen për të mbrojtur interesin publik.

5. SINJALIZUESIT JO VETËM SI PUNËTORË

Kosova ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt mbrojtjes së sinjalizuesve në kontekstin e marrëdhënies së punës. Ndërsa Ligji aktual i Kosovës i njeh të drejtat e sinjalizuesve, jo vetëm për të punësuarit por edhe për personat tjerë si psh. konsulentët e jashtëm. Ky ligj, megjithatë, duhet të promovohet më shumë për të siguruar që të gjitha kategoritë, të ndihen të inkurajuar të sinjalizojnë.

Në përputhje me Direktivën, ligji i Kosovës i njeh të drejtat e sinjalizuesve nëpërmjet përfshirjes së një game të gjerë individësh, përfshirë punëtorët e pavarur, praktikantët, dhe të tjerë që mund të kenë informacion të rëndësishëm në kontekstin e punës. Megjithatë, në praktikë, ky përqendrim i ligjit është perceptuar kryesisht si një mjet për mbrojtjen e punëtorëve në marrëdhënie të rregullt të punës.

Sinjalizues: Çdo person i cili raporton ose shpalos informacione për një kërcënim ose cenim të interesit publik në kontekstin e marrëdhënies së vet të punës, në sektorin publik ose privat.

Opsionet që ligji jep për personin në kontekst të marrëdhënies së punës janë: personi fizik i cili është apo ka qenë në marrëdhënie pune në një institucion publik ose subjekt privat, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës, kohëzgjatja ose pagesa; bashkëpunëtor i jashtëm, vullnetar, kandidat për punësim, ose në marrëdhënie kontraktuale për shërbime, apo lloje të tjera bashkëpunimi. Kriteri që ligji për mbrojtje të sinjalizuesit parasheh në definimin e termit sinjalizues është lidhja me marrëdhënie të punës me institucionit për të cilin raporton.

Në këtë kuptim, është e rëndësishme të promovohet ideja se kushdo që ka informacion të rëndësishëm, pavarësisht nga forma dhe lidhja me ose pa marrëdhënie të punës, ka të drejtë të jetë sinjalizues. Kjo përfshin punëtorët e pavarur, praktikantët, ish-punëtorët, dhe të gjithë ata që mund të kenë informata të rëndësishme. Kjo e

fundit mund të përfshijë një qytetar aktiv që është dëshmitar i një keqpërdorimi dhe nuk ka marrëdhënie pune me institucionin në të cilin po kryhet keqpërdorimi.

Në përfundim, për të bërë ligjin e mbrojtjes së sinjalizuesve më efektiv, është e nevojshme jo vetëm të njihen të drejtat e sinjalizuesve, por edhe të promovohet një kulturë ku të gjithë, pavarësisht nga forma e lidhjes me raportimin e kryer, të ndihen të lirë të sinjalizojnë pa frikë nga ndëshkimi apo diskriminimi.

6. CILAT INSTITUCIONE OBLIGOHEN TË KENË MEKANIZMA RAPORTUESE

Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve obligon si institucionet publike, ashtu edhe ato private për të krijuar mekanizma për pranimin dhe trajtimin e sinjalizimeve. Edhe pse ky ligj ka qenë një hap i rëndësishëm drejt promovimit të transparencës dhe llogaridhënies në mjedisin e punës, zbatimi i tij në sektorin privat është i pamjaftueshëm dhe në disa raste i pamundur.

Sinjalizimi në sektorin publik

Është obligim ligjor i secilit institucion publik me më shumë se 15 punonjës të përcaktoj zyrтарin përgjegjës për praninë dhe trajtimin e sinjalizimeve. Vendosja e një kufiri më të ulët për numrin e punonjësve në sektorin publik siç është në bërë në legjislacionin e Kosovës ku përcaktohet minimumi prej 15 punonjësve për sektorin publik kundrejt 50 që përcakton direktiva e BE-së, mund të ketë sjellë disa efekte negative.

Në këtë rast sektori publik është detyruar të përcaktoj një zyrтар përgjegjës edhe tek institucionet me një numër të ulët të punonjësve. Kjo ka bërë që institucionet të përballen me një mbingarkesë në administratë dhe kosto shtesë, duke pasuar me efikasitet të ulët në zbatimin e rregullave dhe ligjit.

Ministria e Kulturës së Republikës së Kosovës ka publikuar në faqen e saj të internetit emrat e 15 nëpunësve si persona përgjegjës për praninë dhe trajtimin e sinjalizimeve në institucionet që janë nën përkujdesjen e kësaj ministrie. Kjo sugjeron se ligji ka shkaktuar një mbingarkesë të panevojshme për institucionin.

Ulja e pragut në 15 punonjës në sektorin publik mund të sjellë një mungesë transparence dhe pavarësie për procesin e mbrojtjes së denoncuesve, duke rrezikuar të krijojë një mjedis ku ata mund të ndjehen pakëndshëm apo të frikësuar për të raportuar shkelje. Në këto raste sinjalizimi i drejtpërdrejtë është më efikas.

Kufizimi i numrit të punonjësve që janë të përfshirë në rregullat e mbrojtjes së denoncuesve në sektorin publik mund të nxitë një kulturë të mbulojës dhe mungesë të një ambienti të sigurt për raportim të lirë dhe të hapur të shkeljeve.

Është e rëndësishme që përcaktimi i këtyre rregullave të bëhet duke i konsideruar nevojat dhe kapacitetet e sektorit publik, për të siguruar një mbrojtje të efektshme të denoncuesve dhe për të forcuar integritetin e institucioneve.

Sinjalizuesit në Sektorin Privat

Përqendrimi kryesor ka qenë tek institucionet publike, duke lënë sektorin privat pa u trajtuar në mënyrën e duhur, dhe duke krijuar një mungesë të vërtetë të mbrojtjes dhe inkurajimit për sinjalizuesit në këtë sektor.

Një nga arsyet për këtë mungesë të zbatimit është që kompanitë private shpesh kanë qasje të ndryshme ndaj politikave të punës dhe proceseve administrative krahasuar me institucionet publike. Në disa raste, interesat e biznesit, si minimizimi i kostos dhe mbrojtja e reputacionit, kanë pasur përparësi mbi promovimin e kulturës së sinjalizimit dhe përkujdesjes ndaj personave që zbulojnë shkelje të rënda të ligjit ose sjellje të pakuptueshme në vendin e punës.

Një analizë e kujdesshme e këtij ligji tregon se, përkundër synimeve të mira, ligji ka vështirësi në zbatim në sektorin privat. Edhe pse ligji ka pasuar qëllime të mira për të krijuar një mjedis ku sinjalizuesit janë të mbrojtur nga ndjekja e padrejtë, struktura dhe kërkesat e tij duket të përputhen me kushtet dhe karakteristikat e sektorit publik. Sektori privat, me kërkesat dhe rreziqet e tij të veçanta, mund të hasë vështirësi në zbatimin e këtij ligji në mënyrë efikase.

Për të siguruar një implementim të suksesshëm në sektorin privat, një hap i rëndësishëm do të ishte të diskutohej ligji me komunitetin e biznesit. Përfaqësuesit e biznesit duhet të kenë një rol aktiv në zbatimin e këtij ligji për të siguruar që ai të jetë i pranueshëm dhe pragmatik.

Në rast se kompanitë private kanë vështirësi financiare apo teknike për të zbatuar ligjin në mënyrë direkte, duhet të konsiderohet një mekanizëm alternativ i implementimit. Për shembull, mund të mendohet opsioni që shërbimet për zyrtarin përgjegjës të sinjalizuesve të kontraktohen me palë të treta, sipas nevojës, duke garantuar që ligji zbatohet pavarësisht mungesës së burimeve njerëzore të kompanive private.

Lidhur me obligimet që rrjedhin nga ligji, kompanitë private të cilat kanë më shumë se pesëdhjetë (50) të punësuar janë të obliguar të caktojnë zyrtarin përgjegjës. Por kjo nuk shihet si kërkesë e arsyeshme nga sektori privat dhe rrallë herë praktikohet.

Edhe vendet e BE-së kanë parashikuar një periudhë tranzicionale për kompanitë me më pak se 250 punonjës për të krijuar kanale të brendshme të raportimit, në përputhje me detyrimet ligjore. Megjithatë, në Kosovë, nuk është trajtuar në asnjë mënyrë kjo situatë, sidomos për sektorin privat që nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet ligjore të vendosura. Në Kosovë, nuk është lejuar as mundësia opsionale për trajtimin e sinjalizimeve në mënyra alternative për kompanitë që nuk janë në gjendje të përmbushin detyrimet e krijuara nga ligji. Megjithëkëtë, mund të konsiderohen zgjidhje të tjera, si përdorimi i platformave të specializuara për raportimin e ngjarjeve, ose bashkëpunimi me organizata të specializuara për ofrimin e këtyre shërbimeve. Këto mjete alternative mund të jenë opsionale për kompanitë gjatë periudhës tranzicionale deri në krijimin e kapaciteteve të nevojshme për zbatimin e ligjit.

7. SINJALIZIMI I JASHTËM

Sinjalizuesi mund të bëjë sinjalizim të jashtëm pasi ka kryer sinjalizimin e brendshëm, apo drejtpërdrejtë në raste të veçanta. Pra ligji thekson nevojën për përfshirjen e institucioneve të rëndësishme si Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, Inspektorati i Punës, dhe Rregullatorët relevantë. Megjithatë, ndonjëherë mënyra se si janë ndarë përgjegjësitë midis këtyre institucioneve mund të shkaktojë paqartësi për ata që janë të interesuar të raportojnë veprime të dyshimta ose të paligjshme.

Paqartësia krijohet nga mungesa e një sistemi të qartë raportimi jashtë institucionit. Kjo paqartësi mund të bëjë që sinjalizuesit të kenë vështirësi në identifikimin e vendit të duhur për të bërë sinjalizimin e tyre. Prandaj, është e rëndësishme të krijohen

mekanizma të qarta që ofrojnë opsione për raportim, në mënyrë që sinjalizuesit të drejtohen në institucione relevante pas sinjalizimit fillestar. Një zgjidhje e mundshme për këtë problem është fuqizimi i rolit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, ku ky institucion do të mund të sigurojë një rrugë të qartë për sinjalizuesit për të raportuar rastet e tyre dhe për të garantuar një trajtim efikas dhe transparent.

Një nga sfidat kryesore që përballen sinjalizuesit është frika e përballimit me pasoja negative, duke përfshirë humbjen e besimit në organizatën ku punojnë. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme që të ekzistojnë mekanizma për sinjalizuesit, e të cilin ndihen që rastet e tyre nuk trajtohen me seriozitet brenda organizatës. Pasi që ligji e parasheh sinjalizimin e jashtëm vetëm në disa raste të specifikuar me ligj, do të thotë se sinjalizuesi duhet të argumentoj se pse ka vendosur që sinjalizimin ta bart jashtë institucionit, kjo gjë mund të bëhet problem pasi që një arsyetim i tillë lehtë mund të refuzohet si i pa bazë.

Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme të konsiderohet se ndarja e përgjegjësive midis institucioneve rregulluese është shumë komplekse në sektorin privat. Kompleksiteti i kësaj ndarjeje mund të bëjë që sinjalizuesit të ndjehen të frustruar ose të humbasin besimin në procesin e raportimit. Prandaj, krijimi i një sistemi të qartë dhe të integruar për sinjalizuesit në të gjitha sektorët, do të ndihmojë në krijimin e një mjedisi më thjeshtë, të kuptueshëm dhe të drejtë për të gjithë.

8. SI MUND TË SINJALIZOHET

Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve kërkon që në çdo institucion të caktohet një person përgjegjës për pranimin dhe trajtimin e sinjalizimeve në interes publik. Kjo është për të siguruar që sinjalizuesit kanë një kanal të qartë dhe të dedikuar për të bërë raportime, dhe për të garantuar që këto raportime trajtohen në mënyrë të duhur dhe të përgjegjshme nga institucioni relevant.

Në mungesë të zyrtarit përgjegjës, apo në raste konflikti interesi, sinjalizuesit mund të drejtohen drejtpërdrejtë drejtuesve të punëdhënësit për të bërë raportime sipas ligjit.

Informacioni për personin përgjegjës për sinjalizuesit duhet të jetë i qasshëm dhe i disponueshëm për publikun. Kjo mund të bëhet duke e publikuar emrin dhe pozitën e personit të caktuar për këtë detyrë në faqen zyrtare të institucionit, duke përfshirë

edhe informacion shtesë për kontaktim dhe udhëzime për sinjalizuesin. Kjo transparencë ndihmon në rritjen e besimit të publikut dhe në sigurimin e një kanali të besueshëm për raportime të sinjalizuesve.

Sidoqoftë, duke analizuar faqet zyrtare të institucioneve, vërehet se publikimi i zyrtarëve përgjegjës për sinjalizime është i paplotësuar, pasi që shumica e institucioneve kanë të publikuar emrat, por mungon një mënyrë e konsoliduar për identifikimin e tyre në faqen e internetit. Disa institucione e publikojnë zyrtarin përgjegjës në faqen e kontaktit, disa në seksionin për mbrojtjen e të dhënave personale, ndërsa në disa raste është e vështirë të gjendet emri i tyre. Përveç emrit dhe mbiemrit, informacione të tjera si numri i telefonit dhe adresa elektronike janë të publikuara pjesërisht ose edhe fare. Poashtu, mungojnë udhëzimet bazike për raportimin e sinjalizimeve. Kjo tregon një mungesë të transparencës dhe vështirëson qasjen e qytetarëve në kanalin e duhur për të bërë raportime në interes publik.

Shumica e institucioneve publike i publikojnë emrat e personave përgjegjës për pranimin dhe trajtimin e sinjalizimeve, por këtyre personave i referohen si "sinjalizues". Sinjalizuesit janë personat që raportojnë për keqpërdorime në organizatë dhe jo zyrtarët përgjegjës për pranimin dhe trajtimin e sinjalizimeve.

Numrat kontaktues dhe adresa elektronike të publikuara duhet të jenë të dedikuara ekskluzivisht për sinjalizuesit dhe të mos përdoren për qëllime të tjera. Kjo siguron që sinjalizuesit të kenë një rrugë të drejtpërdrejtë gjë që thjeshtëzon raportimin e shkeljeve pa frikë nga zbulimi i menjëhershëm dhe/apo hakmarrja eventuale.

Mos publikimi i qartë i personave përgjegjës për pranimin dhe trajtimin e sinjalizimeve dërgon një mesazh negativ që institucionet nuk i marrin seriozisht raportimet e sinjalizuesve. Kjo mungesë e transparencës dhe e qasjes së lehtë për të identifikuar zyrtarin përgjegjës mund të shkaktojë mospërfillje të çështjes dhe të dekurajojë sinjalizuesit potencial nga raportimi. Në këtë mënyrë, mungesa e publikimit të qartë të informacionit kontaktues për zyrtarin përgjegjës për sinjalizime mund të ulë besimin e qytetarëve në aftësinë dhe seriozitetin e institucioneve për të trajtuar dhe adresuar çështjet e rëndësishme në mënyrë profesionale dhe transparente.

9. ÇFARË MBROJTJE OFROHET PËR SINJALIZUESIT?

Mbrojtja gjyqësore e sinjalizuesve në Kosovë sjell në vëmendje një realitet të sfidues, ku proceset gjyqësore mund të zgjasin shumë, deri në pesë vite. Ky fakt shpreh një vonesë të konsiderueshme që sinjalizuesit duhet të përballojnë në kërkimin e drejtësisë dhe mbrojtjes nga veprimet e dëmshme.

Në këtë kontekst, një rekomandim i rëndësishëm është krijimi i një institucioni të specializuar, i cili do të merret me vlerësimin dhe vendosjen e masave mbrojtëse për sinjalizuesit brenda një afati të shkurtër, p.sh., 30 ditë. Modeli i Këshillit Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil, që vepron me shpejtësi dhe efikasitet, mund të jetë një shembull i mirë për ndjekje. Ky institucion do të mundësonte një reagim të shpejtë dhe të drejtë, duke garantuar që sinjalizuesit të kenë mbrojtjen e nevojshme pa humbur kohë të panevojshme në proceset gjyqësore të zgjatura.

Vonesat në proceset gjyqësore mund të shërbejnë si pengesë për qytetarët dhe punonjësit që vendosin të denoncojnë padrejtësitë. Për të thelluar angazhimin e Kosovës për transparencë dhe llogaridhënie, krijimi i një mekanizmi të shpejtë dhe efikas me përgjegjësi specifike mbrojtjen e sinjalizuesve do të ishte një hap i rëndësishëm. Ky institucion do të duhet të ketë autoritetin për të shqyrtuar dhe vendosur për masat mbrojtëse, duke siguruar se sinjalizuesit nuk do të jenë të ekspozuar ndaj pasojave të dëmshme për një kohë të gjatë.

Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve përqendrohet kryesisht në garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes së personit që sinjalizon shkeljet në vendin e punës. Megjithatë, ky ligj zakonisht nuk përmban dispozita specifike për situatat kur sinjalizuesi mund të dëmtohet nga mekanizma jashtë organizatës, siç janë fushata linçuese në media apo hakmarrja nga individë të tjerë që nuk janë pjesë e organizatës. Drejtimi i vetëm për të kundërshtuar këto veprime hakmarrëse është padia civile, proces i cili përpos resurseve financiare merr edhe shumë kohë për tu vendosur përfundimisht.

Në rastet kur sinjalizuesi rrezikon të preket nga hakmarrja jashtë organizatës, siç janë fushatat linçuese në media, ky ligj mund të jetë i papërshtatshëm ose i pasaktë për t'i ofruar mbrojtje të mjaftueshme. Kjo mund të ndodhë për shkak të mungesës së specifikës së dispozitave ligjore për këto situata.

Për të adresuar këtë boshllëk në ligjin aktual, është e rëndësishme që legjislacioni për mbrojtjen e sinjalizuesve të përfshijë dispozita që të ofrojnë mbrojtje të qëndrueshme edhe në rastet kur sinjalizuesit përballen me hakmarrje nga mekanizma jashtë organizatës. Këto dispozita mund të përfshijnë, për shembull, ndalimin e

diskriminimit të sinjalizuesve në media apo masat për të ndaluar hakmarrjen nga individë të tjerë që nuk janë pjesë e organizatës, të paktën derisa rasti i sinjalizuar është ende në shqyrtim.

Në përgjithësi, për të rritur efektivitetin dhe për të siguruar një mbrojtje të plotë për sinjalizuesit, është e nevojshme që ligjet për këtë kategori të përfshijnë dispozita të qarta dhe të përmbushin nevojat për mbrojtjen nga hakmarrja në të gjitha format e mundshme, përfshirë ato që vijnë nga mekanizma jashtë organizatës.

Prandaj, Kosova ka nevojë për ndryshime dhe përmirësime në sistemin e saj juridik për të garantuar një mbrojtje të shpejtë dhe efikase për sinjalizuesit. Krijimi i një institucioni të specializuar (ose si funksion i veçantë i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit) do të përshpejtonte procedurat dhe do të thellonte besimin në sistemin e mbrojtjes së sinjalizuesve duke shërbyer kështu si masë nxitëse për sinjalizim.

10. BARRA E PROVËS

Ligji për Sinjalizim ka dispozita specifike lidhur me barrën e provës në rastet kur sinjalizuesi ose personi i lidhur me sinjalizuesin e konsideron se ka pësuar dëme nga veprime të dëmshme për shkak të sinjalizimit. Ky ligj vendos barrën e provës në mënyrë të caktuar dhe ofron një strukturë ligjore për situatat kur punëdhënësi pretendon se veprimet e dëmshme nuk kanë lidhje shkakore me sinjalizimin.

Sipas këtij ligji, punëdhënësi ka detyrimin e provës për të dëshmuar se veprimi i dëmshëm nuk ka lidhje shkakore me sinjalizimin. Kjo do të thotë se në rast se një person që ka sinjalizuar për një situatë apo shkelje ligjore ndjen se është dëmtuar për shkak të sinjalizimit, punëdhënësi duhet të paraqesë prova për të argumentuar se veprimi i dëmshëm nuk ka ndodhur.

Nëse ka nevojë për masë të veçantë të mbrojtjes, ligji gjithashtu lejon sinjalizuesin dhe personin e lidhur me sinjalizuesin të paraqesin një propozim për caktimin e masës së sigurimit në kërkesëpadi në një gjykatë kompetente. Kjo tregon se ligji përmban mekanizma të veçanta për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e personave që bëjnë sinjalizime, duke u siguruar se ata nuk do të vuajnë pasoja negative si rezultat i veprimit të tyre të sinqertë dhe të nevojshëm për zbulimin e shkeljeve.

11. ANONIMITETI DHE KONFIDENCIALITETI

Neni 11 i Ligjit përqendrohet në aspektin e konfidencialitetit në kontekstin e sinjalizimeve në interes publik në Kosovë. Ky nen parashikon një sërë detyrash dhe kushtesh që duhet të ndjekin zyrtarët përgjegjës dhe të tjerët që shqyrtojnë raportet e sinjalizimeve.

Obligimi i Konfidencialitetit, nënkupton se zyrtari përgjegjës dhe çdo person tjetër që pranon ose përpunon raportime në interes publik duhet të ruajë konfidencialitetin e informacionit të lidhur me sinjalizimin. Kjo përfshin mos-përhapjen apo transmetimin e informacionit tek persona të tretë brenda ose jashtë institucionit. Konfidencialiteti mund të shpëputet vetëm me pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit ose për të përmbushur një detyrim ligjor, përfshirë hetimin e shkeljeve ligjore, parandalimin e rrezikut për sigurinë e shtetit, shëndetin publik, sigurinë publike, ose mjedisin, si dhe për domosdoshmërinë e zbulimit në interes publik.

A është "njoftimi anonim" i njëjtë me "njoftimin konfidencial"?

"Njoftimi anonim" nuk është i njëjtë me njoftimin konfidencial. Njoftimi konfidencial do të thotë që identiteti i personit që bën njoftimin është i njohur (nga të paktën një person ose entitet, si p.sh. pranuesi i raportit/zyrtari përgjegjës ose hetuesi), por mbetet i mbrojtur.

Mos njoftimi i personit të përmendur në sinjalizim nënkupton se Zyrtari përgjegjës dhe personat tjerë të përfshirë në shqyrtim të raportimit, nuk duhet të njoftojnë personin e përmendur në sinjalizim, përveç nëse kërkohet domosdoshmërisht me ligj. Ky parim synon të ruajë identitetin e personit që sinjalizon dhe të ndalojë informacionin e panevojshëm që mund të shpërndahet në institucion.

Pëlqimi i sinjalizuesit për zbulimin e identitetit nënkupton se Zyrtari përgjegjës duhet të marrë pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit në rast se kërkohet të japë të dhëna që mund të zbulojnë identitetin e saj/tij tek një autoritet kompetent. Ky parim thekson rëndësinë e ruajtjes së privatësisë së sinjalizuesit dhe krijon një procedurë për garantimin e pëlqimit të tij para se të ndodhë zbulimi i identitetit.

Njoftimi i Sinjalizuesit në raste zbulimi të identitetit është kriter i vendosur në ligj. Në rastet kur kërkohet me ligj të zbulohet identiteti i sinjalizuesit, zyrtari përgjegjës duhet të njoftojë sinjalizuesin për këtë fakt para se të ndodhë zbulimi. Ky parim siguron transparencë dhe komunikim të hapur me personin e sinjalizuar në lidhje me veprimet që do të ndërmerren në rast zbulimi të identitetit të tij.

Neni 11 i Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve, rregullon me kujdes procedurat dhe kufizimet e lidhura me konfidencialitetin e sinjalizuesve, duke siguruar një balancim në mbrojtjen e sinjalizuesve dhe nevojës për të ndërmarrë veprime ligjore apo administrative në interes publik.

Sipas rregullores për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit, zyrtarit përgjegjës i sigurohet një email adresë e veçantë ku ka qasje vetëm zyrtari përgjegjës, kjo adresë duhet publikuar në ueb faqe (edhe pse rregullorja nuk e përmend këtë) të institucionit së bashku me identitetin e zyrtarit përgjegjës.

Gjithsesi, mungesa e dispozitave për raportim anonim në Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve rrit sfidat dhe kufizon lirinë e sinjalizuesve. Në këtë kontekst, ky ligj edhe pse rregullon me kujdes ruajtjen e konfidencialitetit, mungesa e një opsioni për raportim anonim mund të shkaktojë ndërprerje në sigurimin e informacionit kritik për organizatat.

Në mungesë të mundësisë së raportimit anonim, sinjalizuesit mund të përballen me frikë dhe kufizime në shprehjen e shqetësimeve të tyre. Organizatat, duke mos ofruar një kanal anonim të raportimit, mund të humbin vëmendjen e mundshme të sinjalizuesve dhe informacionin e rëndësishëm që ata mund të ofrojnë. Ky hendek midis nevojave të sinjalizuesve për siguri dhe mungesës së një opsioni për raportim anonim krijon një klimë të pakëndshme dhe penguese për sinjalizim potencial.

Për të përmirësuar efektivitetin e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, do të ishte e rëndësishme që ai të përfshijë një dispozitë e cila lejon raportimin anonim. Ky element do të kontribuonte në thyerjen e barrierave dhe inkurajimin e një numri më të madh të sinjalizuesve për të paraqitur shqetësimet e tyre pa frikë nga hakmarrja dhe veprimet e dëmshme që mund të rrjedhin si pasojë e raportimit.

Në ambientet e kompanive të vogla ose në grupet e vogla të punonjësve, konfidencialiteti dhe mbrojtja e identitetit të sinjalizuesit dhe informacionit të sinjalizuar është e pasigurt. Në këto situata, personat që janë pjesë e një ekipi të vogël

janë më të prirur të njohin njëri-tjetrin dhe të shkëmbejnë informata konfidenciale, duke pamundësuar kështu ruajtjen e fshehtësisë. Është e rëndësishme që kjo çështje të njihet dhe të trajtohet me kujdes përpara se të shfaqen shkelje të mundshme të konfidencialitetit. Masa të tilla përfshijnë rritjen e ndërgjegjësimit të punonjësve lidhur me rëndësinë e mbajtjes së informacionit në mënyrë konfidenciale, përmirësimin e politikave dhe procedurave të konfidencialitetit dhe trajnimet e vazhdueshme për të gjithë pjesëmarrësit në procesin e sinjalizimit dhe sidomos personit përgjegjës për shqyrtim të raportimit.

Duhet theksuar se pavarësisht nga konfidencialiteti dhe mbrojtja e identitetit të sinjalizuesve dhe informacionit të sinjalizuar, mosha dhe madhësia e një kompanie ose grupi punonjësish mund të sjellë sfida specifike në ruajtjen e konfidencialitetit në praktikë. Kjo sfidë duhet adresuar në mënyrë aktive për të zvogëluar rreziqet dhe pasojat e shkeljes së konfidencialitetit të identitetit të sinjalizuesit por edhe të informacionit të sinjalizuar. Mundësimi i raportimit anonim do shërbente si masë parandaluese për këto raste, sidomos në mbrojtje të identitetit të sinjalizuesve.

12. DISPOZITAT KUNDËRVAJTËSE PËR MOSZBATIM TË LIGJIT

Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në Kosovë përcakton dispozitat kundërvajtëse për raste të ndryshme të shkeljes së ligjit nga institucionet publike, subjektet private dhe autoritetet kompetente. Dënimet e parashikuara janë në formë të gjobave, dhe varen nga lloji dhe natyra e shkeljes.

Nëse nuk mbrohet sinjalizuesi dhe masa të nevojshme nuk ndërmerren për ndërprerje të veprimit të dëmshëm apo eliminimit të pasojave të këtij veprimit 500 deri në 20.000 euro është gjobitja e paraparë me ligj për institucionin publik apo subjektin privat.

Ndërkaq, kur të punësuarit e një institucioni publik apo subjekti privat nuk informohen për mundësinë dhe modalitetet e sinjalizimit, kur nuk caktohet një zyrtar përgjegjës për shqyrtim të raportimeve, kur nuk ndërmerren veprime të nevojshme pas raportimit, dhe kur nuk njoftohet sinjalizuesi për rezultatin e procedurës, ligji parasheh gjobë prej 300 deri në 2000 euro. Në këto raste gjobitet zyrtari përgjegjës i institucionit publik, subjektit privat, apo autoritetit kompetent.

Procedura e kundërvajtjes mund të nisët me kërkesë në Gjykatën kompetente sipas detyrës zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsion për sektorin publik dhe Inspektorati i Punës për sektorin privat. Në raste kur institucionet përgjegjëse nuk ndërmarrin veprime ose refuzojnë të veprojnë brenda gjashtëdhjetë 60 ditëve, sinjalizuesi mund të iniciojë vetë procedurën.

Në raste të përsëritjes së shkeljes, personi përgjegjës mund të ndëshkohet me gjobë deri në shumën e dyfishuar të paraparë në ligj.

Përmbajtja e ligjit, parasheh këto dispozita kundërvajtëse si mjet për të siguruar zbatimin e ligjit dhe për të ndëshkuar shkelësit potencialë të mbrojtjes së sinjalizuesve në Kosovë.

Derisa dispozitat kundërvajtëse të përcaktuara në ligj tregojnë një përpjekje për të siguruar zbatimin e sanksioneve për shkelësit e ligjit, është e rëndësishme të përmendet se, deri më tani, praktika nuk ka treguar asnjë rast të një punëdhënësi që është saksionuar.

Mungesa e shembujve praktikë në të cilat punëdhënësit janë të ndëshkuar mund të sugjerojë se ka disa sfida në zbatimin e plotë të këtyre dispozitave. Është e mundur që implementimi i pjesëve të tjera të ligjit, përveç dispozitave kundërvajtëse, nuk është kryer në mënyrë të duhur apo efektive. Në disa raste, kjo mund të jetë rezultat i mungesës së kapaciteteve institucionale, monitorimit të dobët, ose vështirësive të tjera në zbatim të ligjit.

Është e rëndësishme për autoritetet dhe agjencitë përgjegjëse të rishikojnë dhe të përmirësojnë procedurat për zbatimin e ligjit për të siguruar se të gjitha pjesët, përfshirë dispozitat kundërvajtëse, kanë ndikim dhe efikasitet në praktikë. Mund të jetë e nevojshme hartimi i udhëzimeve të detajuara, trajnimi i personelit të përfshirë, dhe forcimi i mekanizmave të monitorimit për të garantuar zbatimin e duhur të ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve.

13. NXITJA E KULTURËS SË SINJALIZIMIT

Kosova ka bërë hapa të vlefshëm në të mbrojturit e sinjalizuesve përmes ligjit. Megjithatë, zhvillimi i një kulture të sinjalizimit mbetet një kërkesë e rëndësishme.

Përtej strukturave ligjore, shteti duhet të përqendrohet në kultivimin e një mjedisi ku individët ndjehen të mbrojtur dhe nxitur aktivisht të shprehen. Mund të konstatojmë se gjatë viteve, qeverisjet në vend ju ka munguar dhënia e shembujve të mirë për promovimin e raportimit.

Në peizazhin e vështirë të mbrojtjes së sinjalizuesve, miratimi i ligjeve është vetëm një hap fillestar. Një kulturë e sinjalizimit është pika kyçe që transformon legjislacionin në një mekanizëm efektiv për ndërhyrjen e hershme dhe integritetin organizativ. Qeveria e Kosovës nuk ka ndërmarrë hapa substancial për të sjellë shembuj apo për të nxitur aktivisht individët të flasin lirshëm.

Edhe pse strukturat ligjore, duke përfshirë sistemet e sinjalizimit, janë vendosur, efikasiteti i tyre varet prej një kulture që inkurajon dialogun të hapur. Në mungesë të nxitjeve qeveritare për një kulturë të raportimit, punëtorët mund të ndiejnë mungesë përkrahjeje, duke penguar realizimin e masave mbrojtëse të synuara.

Kosova përballet me sfida në nxitjen e një kulture të sinjalizimit për shkak të mungesës së promovimit nga qeveria. Punëtorët mund të kenë hezitim të shprehin shqetësime pa një shembull të qartë nga udhëheqja që tregojnë se veprimet e tyre jo vetëm tolerohen, por vlerësohen. Mungesa e një thirrjeje formale apo informale për individët të flasin lirshëm i lë ata në një gjendje të pasigurtë.

Një qeveri që nxit aktivisht një kulturë të sinjalizimit dërgon një mesazh të fuqishëm në sektorin publik dhe privat. Kjo jo vetëm kultivon një mjedis ku shqetësimet etike adresohen me lehtësi, por gjithashtu forcon reputacionin e vendit si mbështetës i transparencës dhe përgjegjshmërisë. Po ashtu, krijon një precedent për organizatat tjera të ndjekin shembull.

Në një periudhë kur sinjalizuesit luajnë një rol kyç në mbrojtjen e interesave publike dhe private, përkrahja qeveritare është e domosdoshme. Qeveria e Kosovës duhet të ndërmarrë masa proaktive për të thyer heshtjen rreth sinjalizimit, kjo përfshin njohjen formale, miratimin publik dhe përfshirjen e kulturës së sinjalizimit në narrativen më të gjerë të qeverisjes së mirë.

Kosova ka mundësi të rishikojë qasjen e saj, duke njohur se promovimi i kulturës së sinjalizimit nuk është vetëm një detyrim ligjor, por një bazë e krijimit të shoqërisë transparente dhe të përgjegjshme.

Ndërsa Kosova ecën në udhën e saj drejt një të ardhme më transparente dhe të përgjegjshme, ajo nuk duhet të neglizhojë rolin kyç të qeverisë në promovimin e një kulture të sinjalizimit. Mungesa e promovimit formal ose informal pengon ndikimin e mundshëm të ligjeve të mbrojtjes së sinjalizuesve. Është koha që qeveria të udhëhiqet me shembull, duke frymëzuar një shoqëri ku individët ndihen të fuqizuar dhe inkurajuar të flasin për të mirën e përgjithshme.

14. KAPACITETEVE NJERËZORE PËR PRANIM DHE TRAJTIM TË SINJALIZIMEVE

Duke caktuar personat përgjegjës për pranimin dhe trajtimin e sinjalizimeve tek zyrtarët që mbajnë përgjegjësi të tjera në organizatë, dhe duke e trajtuar punën e personit përgjegjës për sinjalizime si përgjegjësi dytësore, detyrat e zyrtarit përgjegjës shpesh herë nuk janë prioritare për zyrtarët në institucione. Si rezultat, këto përgjegjësi mbeten dytësore ose në disa raste, si punë vullnetare për personin e caktuar, pasi që personat në fjalë nuk paguhen shtesë për këto funksione dhe nuk i kanë përgatitjet e duhura për të kryer detyrat e personit përgjegjës për sinjalizime.

Kushti ligjor që personat përgjegjës të caktohen edhe për organizata me minimum 15 punëtorë, ka ngarkuar shumë persona zyrtar me detyra të personit përgjegjës, duke mos lejuar që të krijohen persona të specializuar për këto funksione brenda organizatës. Si rezultat, kemi zyrtarë përgjegjës të cilët nuk janë të trajnuar dhe të motivuar për të kryer detyrat e personit përgjegjës për sinjalizime. Vendimi për caktimin e zyrtarit përgjegjës për pranim dhe trajtim të sinjalizimeve caktohet nga drejtuesi i institucionit.

Vendimi për caktimin e zyrtarit përgjegjës për pranim dhe trajtim të sinjalizimeve caktohet nga drejtuesi i institucionit. Kjo tregon se pozita e zyrtarit përgjegjës mund të jetë subjekt i vullnetit të një individi apo e ndikuar nga drejtuesi i institucionit.

Kjo mund të paraqesë një mundësi ndikimi dhe zhvlerësimi të kësaj pozite, pasi drejtuesi i institucionit mund të ketë ndikim të anshëm në zgjedhjen e personave për këtë rol. Do të ishte më mirë nëse përgjegjësit për caktimin e zyrtarit përgjegjës të rrjedhin nga ligji apo rregulloret, siç është për përgjegjësitë që i bart një pozitë në institucion (për shembull, zyrtar për burime njerëzore). Me rregulloren për

përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit parashihet që nëse një institucion ka zyrtar të caktuar për etikë dhe politika për luftimin e korrupsionit apo çështje të ndërlidhura, i njëjti zyrtar mund të caktohen si zyrtari përgjegjës për sinjalizim.

Kjo do të forconte pozitën e institucioneve për këtë funksion brenda organizatës dhe do të parandalonte ndikimin e vullnetit të drejtuesit të institucionit në zgjedhjen e personave për këtë rol.

Trajnimi është thelbësor për mbrojtjen e drejtave të sinjalizuesve në ambientet e tyre të punës. Kjo përfshin një gamë të gjerë elementesh, duke filluar nga ndërgjegjësimi mbi diskriminimin, nxitja e sinjalizimit dhe sensibilizimi kulturor. Trajnimi duhet të përfshijë të gjithë personelin dhe të jetë i përqendruar në sigurimin e një mjedisi të drejtë dhe mbështetës.

Për një trajnim të suksesshëm, është e rëndësishme që drejtori i përgjithshëm dhe menaxhmenti të angazhohen aktivisht dhe të veprojnë për përmirësimin e standardeve të drejtave të sinjalizuesve. Ata duhet të jenë pjesë e trajnimit dhe të sigurojnë implementimin e politikave dhe procedurave të përshtatshme. Edhe pse në rregulloren për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit trajnimet për sinjalizim duhet të kërkohen nga institucionet publike dhe të organizohen nga institucionet përgjegjëse për trajnime, në këto raste vetëm për zyrtarët përgjegjës për sinjalizim.

Në përgjithësi, synimi është të krijohet një mjedis i ndërgjegjshëm dhe i trajnuar, ku respektohen dhe mbrohen të drejtat e sinjalizuesve në mënyrë efektive. Kjo përfshin një përkushtim të përhershëm nga të gjithë personeli dhe drejtuesit për të garantuar barazinë dhe diversitetin në vendin e punës.

Ngritja e kapaciteteve vetëm përmes trajnimeve periodike dhe për personat që mund të mbajnë pozita zyrtare përgjegjëse në mënyrë të qëndrueshme, nuk siguron krijimin e kapaciteteve të mjaftueshme për trajtimin e rasteve të sinjalizimeve nga institucionet. Kjo është e vërtetë për shkak të dy arsyeve kryesore: Trajnimet janë të limituara në natyrën e tyre kohore dhe në mbulimin e përvojës dhe kompetencave të nevojshme për të trajtuar rastet e sinjalizimit në mënyrë efektive dhe përcaktimi i zyrtarëve përgjegjës për sinjalizime vetëm bazuar në pozicionet e tyre të kohëpaskohshme në organizatë mund të rezultojë në caktimin e individëve që nuk janë të përshtatshëm ose

të kualifikuar për detyrë, duke krijuar mungesë të vërtetë në kapacitetet njerëzore të institucioneve për të trajtuar me sukses rastet e sinjalizimeve.

Prandaj, është e rëndësishme që të krijohen strategji e qëndrueshme për të ngritur kapacitetet njerëzore nëpërmjet trajnimeve të përshtatshme, por gjithashtu duke siguruar që personat që zgjidhen për pozita përgjegjëse për sinjalizime kanë aftësitë dhe përvojën e nevojshme për të përballuar sfidat e kësaj detyre në mënyrë efektive.

15. PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË NË TRAJTIMIN E SINJALIZIMEVE

Në Kosovë, mekanizmi i mbrojtjes së sinjalizuesve brenda institucioneve është i mangët nga mungesa e zgjidhjeve të teknologjisë. Edhe pse anonimiteti nuk lejohet sipas ligjit, por vetem konfidencialiteti, mungesa e infrastrukturës teknologjike sjell sfida të rëndësishme për institucionet dhe ata që dëshirojnë të raportojnë shkelje.

Në Kosovë, konfidencialiteti i sinjalizuesve është sfidë e cila vështirë që mund të tejkalohet pa pasur një strukturë të sigurt të llogaridhënies efektive brenda dhe jashtë institucionit.

Teknologjia luan një rol thelbësor në mbrojtjen e sinjalizuesve dhe përdorimi i saj për strukturat e sinjalizimit është i domosdoshëm. Një platformë raportimit të sinjalizimeve garanton jo vetëm konfidencialitetin e sinjalizuesve, por edhe mbrojtjen e të dhënave personale, lehtëson komunikimin dhe mundëson ndjekjen e hetimeve.

Një nga pengesat kryesore në sistemin e mbrojtjes së sinjalistëve në Kosovë është mbështetja në procese manuale në vend të zgjidhjeve me teknologjike. Në institucione mungojnë softuerë të lehtë për raportimin e sinjalistëve, i cili do të mund të rregullonte procesin e raportimit, do të ofronte kanale të shumëfishta të raportimit dhe do të përshpejtonte hulumtimin e raportimit, dhe në rastet më të mira do mundësonte anonimitetin. Pa ndërhyrjet e tilla teknologjike, punëtorët mund të hezitojnë të sinjalizojnë, duke u frikësuar nga pasojat e raportimit të shkeljeve.

Për më tepër, mungesa e zgjidhjeve të teknologjisë përforcon sfidat lidhur me mbledhjen e provave dhe menaxhimin e çështjeve. Sistemi digjital i sinjalizimit do të lejonte ngarkime të sigurt të provave duke ruajtur anonimitetin e sinjalizuesve gjatë

gjithë procesit. Po ashtu, forma e raportimit e konfigurueshme do të rregullonin hetimet dhe do të siguronin përputhshmërinë me ligjet e sinjalizimit.

Institucionet në Kosovë duhet të njohin rëndësinë e pranimin të teknologjisë për të forcuar mekanizmat e tyre të mbrojtjes së sinjalizuesve. Duke investuar në softuerë për raportimin dhe sisteme të forta të menaxhimit të rasteve, institucionet mund të kultivojnë një kulturë të transparencës, besimit dhe përgjegjësisë. Kjo jo vetëm mbron interesat e sinjalizuesve, por gjithashtu ruan integritetin dhe reputacionin e institucioneve në zbatim të drejtë të ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve.

16. REKOMANDIMET

Pas analizës së Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në Kosovë dhe analizës së implementimit aktual të tij, është parë e nevojshëm që të ndërmerren përmirësime si në aspektin ligjor ashtu edhe në atë organizativ për të siguruar një implementim më efektiv dhe për të adresuar hapësirat.

Kosova ka bërë progres në mbrojtjen e sinjalizuesve në ambientin punës, por për të forcuar implementimin dhe përmirësuar zbatimin e ligjit, rekomandohet promovimi i një kulture ku të gjithë ndjehen të lirë të sinjalizojnë pa frikë nga ndëshkimi apo diskriminimi. Është e rëndësishme të hartohen dhe të zbatohen rregullore dhe udhëzime të qarta për trajtimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në të dy sektorët, publik dhe privat. Krijimi i një institucioni të specializuar për trajtimin e sinjalizimeve brenda një afati të shkurtër është gjithashtu rekomandim kyç për garantimin e mbrojtjes së sinjalizuesve në procesin gjyqësor. Ligji duhet të përfshijë dispozita për raportim anonim për thyerjen e barrierave për raportim. Për të forcuar këtë kulturë të sinjalizimit, është e rëndësishme të ofrohen trajnime të vazhdueshme për personelin dhe të investohet në teknologji për të lehtësuar procesin e raportimit. Përmes këtyre rekomandimeve, Kosova mund të ndërtojë një mjedis të favorshëm për sinjalizuesit dhe të rrisë integritetin institucional në luftën kundër korrupsionit. Bazuar në kontekstin e sinjalizimit në Kosovë, rekomandimet të cilat do të përmirësonin situatën janë:

Promovimi i një kulture të sinjalizimit: Në Kosovë, promovimi i një kulture të sinjalizimit është thelbësor për të garantuar se individët ndjehen të lirë dhe të mbrojtur

për të raportuar shkeljet. Duke ofruar trajnime të vazhdueshme për personelin dhe udhëheqësit, qeveria mund të ndërtojë një mjedis ku sinjalizuesit ndihen të përkrahur dhe të inkurajuar për të denoncuar shkeljet pa frikë nga ndëshkimi apo diskriminimi.

Forcimi i zbatimit të ligjit dhe akteve nënligjore: Nevoja për rishikim dhe përmirësim të mekanizmave të zbatimit të ligjit është e qartë për të siguruar një implementim efektiv dhe të plotë të dispozitave të ligjit. Duke hartuar udhëzime të detajuara dhe duke siguruar trajnim të përshtatshëm për personelin, institucionet mund të forcojnë përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe standardet për trajtimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.

Përfshirja e sektorit privat: Përfshirja e sektorit privat në zbatimin e ligjit është kritike për të siguruar një qasje të plotë në luftën kundër korrupsionit dhe për të forcuar integritetin institucional. Politikat dhe mekanizmat që inkurajojnë bashkëpunimin me sektorin privat, duke përfshirë konsultime të hapura dhe mjete alternative për kompanitë private, janë esenciale për një zbatim të qëndrueshëm dhe efikas të ligjit.

Mbrojtja jashtë gjyqësore e sinjalizuesve: Për të siguruar që sinjalizuesit kanë mbrojtjen e nevojshme nëpërmjet një procesi gjyqësor të shpejtë dhe efikas, krijimi i një institucioni të specializuar për këtë qëllim është i domosdoshëm. Ky institucion duhet të kryejë vlerësimin dhe të vendosë masat mbrojtëse për sinjalizuesit brenda një afati të shkurtër, duke garantuar që ata trajtohen me integritet dhe drejtësi.

Raportimi anonim dhe mbrojtja e konfidencialitetit janë elemente kyçe për të inkurajuar sinjalizuesit në Kosovë për të paraqitur shqetësimet e tyre. Megjithatë, për momentin, raportimi anonim nuk lejohet sipas ligjit, duke krijuar një barrierë për ata që mund të shprehin shqetësime pa rrezikuar pasojat e mundshme negative. Ky kufizim në ligj dëmton rendin e sinjalizimit dhe ul numrin e shkeljeve të raportuara.

Përveç kësaj, kapaciteti për ruajtjen e konfidencialitetit aktualisht është i kufizuar në Kosovë. Pa një mekanizëm efektiv për ruajtjen e konfidencialitetit, sinjalizuesit mund të ndjehen të rrezikuar dhe të përjashtuar nga procesi i raportimit për shqetësimet e tyre.

Sensibilizimi i punonjësve dhe hartimi i politikave dhe procedurave për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit janë kritike për të siguruar një mjedis të sigurt për sinjalizuesit. Përmes forcimit të kapaciteteve për ruajtjen e konfidencialitetit dhe

lejimit të raportimit anonim në ligj, Kosova mund të promovojë një kulturë të sinjalizimit dhe të rrisë besimin në sistemin e drejtësisë.

Dispozitat kundërvajtëse dhe zbatimi i tyre: Sigurimi i zbatimit efektiv të dispozitave kundërvajtëse përfshin rishikimin dhe përmirësimin e mekanizmave të monitorimit për të siguruar që institucionet publike dhe private përmbushin detyrimet e tyre ligjore. Përmes gjobave të konsiderueshme dhe veprimeve të tjera ndëshkuese, institucionet duhet të kuptojnë se mosrespektimi i ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve nuk do të tolerohet.

Përdorimi i teknologjisë dhe raportimi anonim: Për të lehtësuar procesin e raportimit dhe për të siguruar anonimitetin e sinjalizuesve, investimi në teknologji është i domosdoshëm. Platformat e sigurta për raportimin dhe menaxhimin e rasteve ofrojnë një mjet efikas për sinjalizuesit për të denoncuar shkeljet pa rrezikuar identitetin e tyre. Përdorimi i teknologjisë mund të përmirësojë ndjeshmërinë e sistemit dhe të bëjë që procesi i raportimit të jetë më i lehtë dhe më i efikas. Në të njëjtën kohë, raportimi anonim duhet të mbështetet dhe të inkurajohet si një mjet për të garantuar se sinjalizuesit ndjehen të sigurt për të paraqitur shqetësimet e tyre pa frikën e hakmarrjes. Kombinimi i teknologjisë me raportimin anonim mund të jenë faktorë kryesorë në forcimin e mbrojtjes së sinjalizuesve dhe në rritjen e besimit në procesin e raportimit të shkeljeve.

Personat përgjegjës dhe strukturat për trajtimin e sinjalizimeve në vendet e punës: Në mënyrë që të sigurohet një trajtim i drejtë dhe profesional i sinjalizimeve, është e rëndësishme që organizatat të kenë struktura dhe procese të qarta për menaxhimin e zyrtarëve përgjegjës për pranimin dhe trajtimin e sinjalizimeve. Kjo përfshin hartimin e detyrimeve dhe përgjegjësi të personave të caktuar për këtë detyrë, si dhe rregullat për raportimin dhe monitorimin e sinjalizimeve. Përveç kësaj, është e rëndësishme që të caktohen kritere profesionale dhe të ofrohen trajnime për personat përgjegjës, për të siguruar që ata kanë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të trajtuar çështjet e sinjalizimeve në mënyrë të përshtatshme dhe etike. Kjo mund të përfshijë trajnime të specializuara në etikë, ligj, dhe menaxhimin e rasteve për të siguruar që personat përgjegjës kanë njohuritë e nevojshme për të vepruar me profesionalizëm dhe integritet në këtë rol. Përmes krijimit të këtyre strukturave dhe standardeve profesionale, organizatat mund të sigurojnë një trajtim të përkushtuar dhe të drejtë të sinjalizimeve, duke rritur besimin e punonjësve në procesin e raportimit dhe zbatimin e ligjit.

